

Në funksionim platforma «Programim i Caktimit të Takimit për Dorëzimin e Kërkesës së Mëvonshme» e Shërbimit të Azilit

Nga dita e sotme e Hënë, 22/8, vihet në përdorim funksionimi produktiv i platformës «Programim i Caktimit të Takimit për Dorëzimin e Kërkesës së Mëvonshme», e cila u drejtohet azilkërkuesve, kërkesa e mëparshme e të cilëve është refuzuar përfundimisht. Konkretisht, platforma u drejtohet atyre Shtetasve të Shteteve të Treta (SH.SH.T) të cilët dëshirojnë të dorëzojnë përsëri nga fillimi një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë me kusht që kërkesa e tyre e mëparshme të jetë refuzuar përfundimisht.

Platforma u zhvillua dhe është e disponueshme në gjuhët: Anglisht, Arabisht, Bengali, Farsi, Kirmanxhi, Dari, Pasto, Shqip, Turqisht, Urdu, Gjeorgjisht, me mundësinë e zgjerimit në më shumë gjuhë në të ardhmen, nëse do të paraqitet nevoja.

Akses në këtë platformë do të keni nëpërmjet linkut që vijon:

<https://apps.migration.gov.gr/international-protection-registration>

Me qëllim respektimin e duhur të programimit dhe lehtësimin e shërbimit tuaj, jeni të lutur të paraqiteni të paktën 30 minuta më parë nga programimi i takimit tuaj për regjistrim, duke pasur në dispozicionin tuaj të gjithë dokumentet tuaja identifikuese.

Me fillimin e funksionimit të procedurës së mësipërme, aplikacioni Skype që ishte në fuqi deri më parë për caktimin e takimit të regjistrimit, pushon së funksionuari.

Së fundmi, theksojmë që për të gjithë të interesuarit, që deri më sot nuk kanë vizituar Zyrat e Shërbimit Të Azilit dhe nuk kanë dorëzuar asnjëherë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, kjo gjë është e mundshme tashmë nëpërmjet regjistrimit të tyre në pikat: Struktura Malakasa dhe Struktura Dhiavaton duke ndjekur procedurën që përshkruhet në platformën «Kërkesë për programimin e regjistrimit fillestar» tek e cila gjithashtu keni akses nëpërmjet linkut që u përmend më sipër:

<https://apps.migration.gov.gr/international-protection-registration>.